

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kurti përshëndet festivalin e parë shqiptar në Staten Island: Integrimi nuk e zbeh identitetin, por pasuron SHBA-në
ADRESA	https://albeu.com/kosove/kurti-pershendet-festivalin-e-pare-shqiptar-ne-staten-island-in-tegrimi-nuk-e-zbeh-identitetin-por-pasuron-shba-ne/1019456/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 06:05:32 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 06:02:58 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	7fda68ea4c8131147d9892406a87c1f9cc6440d26bbda72f632a66406a49e38c
TEKSTI	8edee7cb57fbb71dcaaa75d5b3fa42e6c069fa6fac693f561e01224f7a58603c
PAMJA	98c70e5321b4a8348f935d049f85e7fa492f8c09537924a444cbae60d01c315b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	bc3fd3ca57cdb9bd41aa6e0a99001ac6374e68341b97d8c976591295961632a3
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c5e5acf6a90124295988d6d58bc3c7b969f0482d5f27d66820a4865368f8d785
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/bc3fd3ca57cdb9bd41aa6e0a99001ac6374e68341b97d8c976591295961632a3>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Kurti përshëndet festivalin e parë shqiptar në Staten Island: Integrimi nuk e zbeh identitetin, por pasuron SHBA-në



Komuniteti shqiptar në Staten Island të Shteteve të Bashkuara të Amerikës u mbledh për herë të parë në "Albanian Festival", një ngjarje e organizuar me muzikë, ushqime tradicionale dhe kulturë shqiptare.

Festivali, i mbajtur në South Beach Boardwalk, bashkoi brezat e shqiptarëve që mbërritën të parët në Amerikë me ata që kanë lindur atje. Familjet shqiptare janë prej brezash pjesë e historisë dhe jetës së New York-ut, ndërsa fëmijët e tyre sot kanë arritur sukses në biznes, mjekësi, teknologji, inxhinieri, universitete, administratë dhe shërbim publik.

Veprimtarinë e hapi organizatori kryesor i festivalit dhe kryetari i Shoqatës Shqiptaro-Amerikane, Naser Nika, i cili nënvizoi rëndësinë e bashkimit të shqiptarëve që jetojnë larg vendlindjes.

Në këtë festival mori pjesë edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i cili iu drejtua komunitetit me një fjalim të përqendruar te diaspora, ruajtja e gjuhës shqipe dhe kujtesa historike.

Kurti u tha të pranishmëve se ishte i nderuar të ndodhej në një vend ku identiteti kombëtar kremtohej përmes kulturës, muzikës dhe ushqimit. Ai kujtoi se prej disa brezash shqiptarët janë pjesë e historisë së Nju Jorkut, përfshirë familjet me prejardhje nga Kosova, Shqipëria, Mali i Zi, Lugina e Preshevës, Maqedonia e Veriut dhe të gjitha trevat shqiptare.

"Shumë prej jush mbërritën me pak, por sollën me vete punën, sakrificën dhe shpresën për të ardhmen e fëmijëve. Sot, brezat e rinj kontribuojnë në biznes, mjekësi, inxhinieri, universitete dhe shërbim publik. Pikërisht ky është suksesi i diasporës: ta ruash identitetin tënd dhe njëkohësisht të japësh kontribut në vendin ku jeton", tha Kurti.

të fundit /



Takim mbarëshqiptar në Kalabri, në qendër trashëgimia arbëresh...



Policia e Kosovës sqaron masat e ndërmarra gjatë...



Protesta hyn në natën e pestë, qytetarët mbledhen sërish në...



Mbahet sot protesta e 113-të! Qëndresa vazhdon, qytetarët...



Kthjellime dhe vranësira, në zonat malore priten reshje...



Goditje për Spallettin, portieri i Juventusit këput ligamentin e gjurit



Horoskopi për ditën e diel, 20 Shtator 2026



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Sipas kryeministrit, është e mundur që njëkohësisht të duash Amerikën dhe vendin nga i cili vjen familja jote. Ai theksoi se integrimi në shoqërinë amerikane nuk e zhdok domosdoshmërisht identitetin shqiptar, por e bën edhe më të pasur mozaikun e saj.

Ruaftjen e shqipes, Kurti e cilësoi si një ndër përgjegjësitë më të rëndësishme ndaj brezave që do të vijnë, duke thënë se shqiptarët në diasporë, e veçanërisht ata në Amerikë, po e përmbushin këtë detyrë.

"Kur një fëmijë shqiptar në Staten Island e mëson shqipen, ai nuk përvetëson vetëm një gjuhë. Bashkë me të merr historinë, kulturën dhe lidhjen me rrënjët", u shpreh ai.

Duke folur për rolin e mërgatës, Kurti tha se për Kosovën, komuniteti shqiptar në Shtetet e Bashkuara ka përfaqësuar gjithnjë shumë më tepër sesa një diasporë. Sipas tij, ai ka qenë një zë i fuqishëm, një burim i vazhdueshëm mbështetjeje dhe një urë lidhëse me Amerikën.

Në fjalimin e tij, kryeministri përmendi prejardhjen ilire dhe Skënderbeun, si dhe tri data që i cilësoi themelore: Lidhjen e Prizrenit më 1878, Pavarësinë e Shqipërisë më 1912 dhe UÇK-në e Adem Jasharit më 1998. Ai përmendi gjithashtu ndërhyrjen e NATO-s, të udhëhequr nga SHBA-ja, në vitin 1999, si dhe Pavarësinë e Kosovës më 2008.

Kurti foli edhe për ngritjen e shtetit, shtrirjen e sundimit të ligjit deri në veri të Ibrit dhe Forcën e Sigurisë. Vendimin e shkallës së parë në Hagë ndaj Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit ai e quajti të padrejtë, ndërsa shtoi se historia është gjyqtari i vërtetë dhe se shteti do të angazhohet për korrigjimin e tij në apel.

Ai deklaroi se edhe më herët gjykata e UNMIK-ut, por edhe ajo e Hagës, kanë kryer padrejtësi ndaj UÇK-së. Në këtë kontekst, Kurti citoi thënien e një mendimtari të urtë: "Historia ua bën gjyqin gjyqeve".

Kryeministri shprehu më pas vlerësim dhe falënderim të veçantë për Batalionin Atlantik nga SHBA-ja.

Në fjalën e hapjes, Naser Nika deklaroi se komuniteti shqiptar në Amerikë nuk e harron luftën për lirinë e Kosovës, sakrificat, historinë dhe të gjithë ata që dhanë jetën. Ai theksoi se, në këtë moment të vështirë, diaspora duhet të qëndrojë e bashkuar jo vetëm gjatë festimeve, por edhe përballë vështirësive.

Duke iu drejtuar kryeministrit të Kosovës, Nika tha se të pranishmit përfaqësonin një komunitet që e do Kosovën, Shqipërinë dhe tokat shqiptare. Megjithatë jetojnë larg, shtoi ai, Kosova vazhdon të jetë në zemrat e tyre dhe ky festival përbën një dëshmi të bukur të kësaj lidhjeje.

"Sot flamuri kuqezi valëvitet në Nju Jork, ndërsa fëmijët tanë dëgjojnë, këndojnë dhe kërcëjnë shqip. Kjo është forma më e bukur për t'ua përcjellë identitetin brezave. Mos e harroni prejardhjen tuaj, mësojeni shqipen, dua jeni kulturën dhe respektojeni Amerikën, por ruajini rrënjët. Jetën e ndërtojmë këtu, ndërsa identitetin e përcjellim brez pas brezi. Sot po fillojmë një traditë të re; le ta vazhdojmë çdo vit dhe t'i sjellim fëmijët këtu", tha Naser Nika, kryetar i Shoqatës Shqiptaro-Amerikane dhe organizator kryesor i Festivalit të Parë Shqiptar në Staten Island.

Shtuar më 20.09.2026 08:02

Tags: [Albin Kurti](#), [Amerikë](#), [vizita](#)



Policia e Kosovës sqaron masat e ndërmarra gjatë protestës në Prishtinë



Protesta hyn në natën e pestë, qytetarët mbledhen sërisht në sheshin...



Prishtina protestoi edhe sot për çlirimtarët, emigrantët u mbledhën në Europë



Dënimi me 81 vite burg për ish-drejtnesit e UÇK-së, Kurti kërkon strategji...



Tensione në protestën e shqiptarëve në Shtutgart, arrestohen disa...



Apeli në përgatitje, rasti i Gotovinës ushqen shpresat e mbrojtjes



Kurti nga New Yorku: Kosova do të punojë për korrigjimin e verdiktit ndaj...



Gjykata cakton një muaj paraburgim për të dyshuarin pas plagosjes ...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com |

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.